



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në bazë të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-129 për zonat ekonomike, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 2009/24

**PËR MARRËDHËNIET NDËRMJET INSTITUCIONIT PËRGJEGJËS, ZHVILLUESIT
TË ZONËS DHE INSTITUCIONEVE TJERA**

Neni 1
Qëllimi

1. Ky udhëzim administrativ rregullon marrëdhëniet ndërmjet institucionit përgjegjës, zhvilluesit të zonës dhe institucioneve të tjera duke i përcaktuar detyrat e secilit prej tyre.
2. Zhvilluesi i Zonës Ekonomike, institucioni përgjegjës dhe institucionet tjera mbajnë kontakte të vazhdueshme për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Zonat Ekonomike, për të cilat lëshohet vendimi.

Neni 2
Përkufizimet

1. Në kuptim të këtij Udhëzimi termat e përdorur në vijim kanë këto kuptime:
 - 1.1. **Agjencia** - nënkupton Agjencinë për mbështetje të ndërmarrjeve, të vogla dhe të mesme, e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
 - 1.2. **NMVM** - nënkupton ndërmarrjet mikro, të vogla apo të mesme;

1.3. **ZE** - nënkupton Zonat Ekonomike;

1.4. **Institucionet përkatëse** - nënkupton Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Energjetikës dhe Minierave, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve - trashëgimia kulturore, Kuvendin Komunal përkatës, Ministrinë e Transportit dhe Post Telekomunikacionit, si dhe institucionet tjera sipas nevojës.

Neni 3

Marrëdhëniet ndërmjet institucionit përgjegjës dhe zhvilluesit të zonës

1. Agjencia pas pranimit të kërkesës për krijimin e ZE është në kontakt të vazhdueshëm me zhvilluesin dhe:

- 1.1. Identifikon hapësirat e propozuara për krijimin e ZE;
- 1.2. Ndhmon dhe monitoron procedurën për krijimin e ZE;
- 1.3. Përcjellë funksionimin e ZE;
- 1.4. Informon zhvilluesin për çdo ndryshim eventual të ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi që prekin ZE;
- 1.5. Njofton zhvilluesin në rast të ndonjë ndryshimi të mundshëm të vendimit për krijimin e ZE;
- 1.6. Përgjigjet ndaj zhvilluesit për çdo kërkesë që ka paraqitur me shkrim ndaj Agjencisë;
- 1.7. Jep rekomandime dhe vërejtje për mospërmbyshjen e planit dinamik;
- 1.8. Bashkëpunon ngushtë me zhvilluesin edhe për çështje të tjera të nevojshme.

2. Zhvilluesi ka për obligim:

- 2.1. Të njoftoj Agjencinë nëse hasë në ndonjërin nga monumentet kulturo-historike, pasuri të ndryshme natyrore, si dhe çdo lloj tjetër me interes shtetëror gjatë fazës së ndërtimit të zonës;
- 2.2. Ti ofroj Agjencisë planin dinamik të përafërt për ndërtimin e ZE;
- 2.3. Të raportoj për ecurinë e punimeve të ndërtimit;
- 2.4. Të dorëzoj planin dinamik të ndërtimit për vitin vijues;
- 2.5. Të informoj ad-hoc rreth vështirësive që janë paraqitur gjatë punimeve të ndërtimit;
- 2.6. Të njoftoj paraprakisht me shkrim për kërkesë të mundshme nga zhvilluesi për ndryshimin e kushteve të vendimit;
- 2.7. Ti sigurojë, mbajë brenda ZE të gjitha dokumentacionet e nevojshme që kanë të bëjnë me kushtet e vendimit dhe veprimtarinë që zhvillohet brenda ZE;
- 2.8. Të paraqesë të dhëna dhe dokumentacion shtesë, kur kjo kërkohet nga Agjencia;
- 2.9. Të krijojë dhe të paraqesë data basen për të dhënat e shfrytëzuesve (bizneseve) të ZE.

Neni 4

Marrëdhëniet ndërmjet institucionit përgjegjës dhe institucioneve tjera

1. Agjencia i njofton Institucionet përkatëse për të gjitha vendimet që lëshohen për ZE.

2. Agjencia kërkon informata shtesë nga institucionet përkatëse për dokumentet e ofruara nga zhvilluesi.
3. Në raste specifike formohen grupe ekspertesh nga institucionet përkatëse të kryesuar nga Agjencia, për zgjidhjen e çështjeve me interes për ZE.
4. Agjencia bashkëpunon me institucionet përkatëse edhe për çështjet tjera sipas kërkesës.

Neni 5
Dispozitat kalimtare

Mbikëqyrjen për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ e bënë Agjencia për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla apo të mesme.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë.

Prishtinë, 31.12.2009

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë
Lutfi ZHARKU

